

Në bazë të nenit 55 paragrafit 1 të Ligjit për Organizimin dhe Punën e Organeve të Administratës Shtetërore („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 96/19, 110/19 dhe 121/24), dhe neni 102 paragrafi 2 të Ligjit për Arsimin e Mesëm („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 67/04, 55/05, 113/05, 35/06, 30/07, 49/07, 81/08, 92/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17, 64/18, „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 229/20, 78/25, 132/25 dhe 250/25), Ministria e Arsimit dhe Shkencës, solli

**Rregullore
për plotësimin e Rregullores
për mënyrën e ndarjes së mjeteve të Shkollave të Mesme Shtetërore**

Neni 1

Në Rregulloren për mënyrën e ndarjes së mjeteve të Shkollave të Mesme Shtetërore numër 13-14043/1 të datës 05.11.2025, në nenin 11 pas paragrafit 1 shtohet paragraf i ri 2 i cili thotë:

“Shkollat e Mesme Shtetërore, të cilave u ndahen mjete në përputhje me këtë rregullore, dorëzojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës raport për mjetet e shpenzuara sipas zërave dhe destinimit, pas përfundimit të çdo tremujori, në afat prej 15 ditësh.”

Neni 2

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita e sjelljes së saj.

**Министерка за образование и наука/
Ministre e Arsimit dhe Shkencës,
проф. д-р Весна Јаневска**

Nr. 13-9717/1

23.07.2026

Shkup